Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Me/Dana: 24-11-2020
Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojce Prilog | Vlera Vrednost
01-060/01-1239

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 i Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, ne Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës se Vitisë Nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **VIII** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **27.11.2020 (e Premte)**, duke filluar në ora 10,00.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave tek objektin i ri i Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të propozim rregullore për këshillat e fshatrave.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim rregullore për procedurat e brendshme për menaxhim të pasurive jo financiare.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të Propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 01-110/05-920 e datës 01.10.2020.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim vendimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në Komunës së Vitisë.**
6. **Propozim për ndryshim plotësim të vendimit me Nr.01-111/01-1055, i datës 29.10.2020, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NPSH "ARENA SPORT" në Kabash.**
7. **Propozim për shfuqizimin e vendimit me Nr. 02-110/05-1052 i datës 29.10.2020, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal të kryetarit të Komunës së Vitisë me komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj.**
8. **Propozim për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-1053 i datës 29.10.2020, për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunim ndërkomunalë me komunat e Republikës se Kosovës.**
9. **a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nder komunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Gjilanit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
   **b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunat e Gjilanit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
   **c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Gjilanit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
10. **a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nder komunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Ferizajt në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
    **b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunat e Ferizajt në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
    **c) Propozim vendimin për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Ferizajt në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
11. **a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nderkomunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Kaçanikut në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
    **b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunat e Kaçanikut në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**
    **c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kaçanikut në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.**

**Me respekt!**

**Viti, më 24.11.2020**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Naim Pira**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
20-11-2020
02-035/02-1229

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011 si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ – MAPL nr.02/2019 për Organizmin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, Kryetari i Komunës, paraqet këtë:

# PROPOZIM RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË KOMUNËN E VITISË

**Neni 1**

Me këtë Vendim, Propozohet për dhënjen e lejes për diskutim publik propozim rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Vitisë

**Neni 2**

Kjo rregullore, ka për qëllim që të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, themelimin e këshillave lokal, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, duke i siguruar banorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në realizimin e të drejtave, interesave dhe obligimeve të tyre, në shumë fusha të jetës dhe paraqitjes së organizuar para Komunës dhe organeve të saj.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Tetor, 2020

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol HALITI

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Vitisë**
Opština Vitina – Municipality of Vitia

# PROPOZIM RREGULLORE
# PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË KOMUNËN E VITISË

**Viti,**
**Tetor, 2020**

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011 si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ – MAPL nr.02/2019 për Organizmin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, Kryetari i Komunës, paraqet këtë:

# PROPOZIM RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË KOMUNËN E VITISË

## Neni 1
## Qëllimi

Kjo rregullore, ka për qëllim që të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, themelimin e këshillave lokal, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, duke i siguruar banorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në realizimin e të drejtave, interesave dhe obligimeve të tyre, në shumë fusha të jetës dhe paraqitjes së organizuar para Komunës dhe organeve të saj.

## Neni 2
## Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit mes komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

## Neni 3
## Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

1. Në Komunën e Vitisë, vetëqeverisja lokale mund të ushtrohet në nivel të Bashkësive vendore: në qytet si Lagje urbane dhe në fshatra si fshatra ose vendbanime, konform dispozitave ligjore dhe statutare.
2. Komuna e Vitisë themelon 36 këshilla lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe do të paraqiten në listë të veçantë, shtojca nr. 1, që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim ose lagje urbane të zgjedhen këshillat, atëherë një këshill mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

## Neni 4
## Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Kuvendi i Komunës emëron një komision prej 7 anëtarëve: 4 (katër) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike, 1 (një) nga ekzekutivi, 1 (një) anëtarë shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që përcaktohet aty për aty nga tubimi dhe i cili njëkohësisht është bashkë-kryeses i tubimit.

2. Komisioni duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik. Nga 7 anëtarët e Komisionit, të paktën 3 (dy) duhet të jenë femra. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.

3. Se paku 4 (katër) anëtarët të Komisioni Komunal duhet të jenë prezent në tubime me qytetarë.

4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
   a. Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhën këshillat lokale;
   b. Mediave lokale;
   c. Ueb – faqes zyrtare të komunës; dhe
   d. Rrjeteve sociale

6. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë:
   a. Rendin e ditës;
   b. Datën;
   c. Kohën; dhe
   d. Vendin e mbajtjes së tubimit.

7. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.

8. Mandati i Komisionit ndërlidhet me mandatin e Kuvendit të Komunës se Vitisë.

**Neni 5**

**Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane do të ketë pesë (5) deri nëntë (9) anëtarë, varësisht nga numri i banorëve. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill, përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.

2. Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30% të gjinisë femërore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse marrin pjesë në tubimin zgjedhor.

3. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në tubimin me qytetarë.

4. Të drejtë vote kanë të gjithë banoret e fshatit, vendbanimit apo lagjeve urbane përkatëse mbi moshën 18 vjeçare. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.

5. Kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillit lokal, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.

6. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor me ç 'rast duhet të respektohet përfaqësimi gjinor/etnik në strukturën e këshillit. Në rast se dy ose më shumë kandidatë të fundit kanë vota të barabarta, vlen parimi i renditjes në bazë të alfabetit.

7. Tubimin publik e hap kryesuesi i Komisionit të Kuvendit Komunal që e ndihmon në bashkë-kryesim përfaqësuesi i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që përcaktohet aty për aty, i cili njëkohësisht është edhe anëtar i Komisionit të Kuvendit Komunal.

8. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, nuk lejohet të jenë më shumë se një anëtarë/e i/e familjes së ngushtë.

9. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, i cili fiton shumicën thjesht të votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë votim. Në rast se dy apo më shumë kandidatë kanë vota të barabarta për kryetar, atëherë votimi për kandidatët më vota të barabarta përsëritet.

10. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane zgjedhet me mandat 4 vjeçar.

11. Tubimet zgjedhore kanë legalitet dhe legjitimitet juridik, nëse në tubime janë të pranishëm si në vijim:
   a. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banoreve është deri 100, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 11 banorë;
   b. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është nga 100 deri 300, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 21 banorë;
   c. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është nga 300 deri 500, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 31 banorë; dhe
   d. Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është mbi 500, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 41 banorë.

**Neni 6**
**Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale**

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushë obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë (50 % plus 1 votë) të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.

2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky peticion duhet të mbledh nënshkrimet e më shume se gjysmës së numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna, respektivisht Komisioni Komunal duhet të lajmërohet paraprakisht për një mbledhje të tillë.

3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave në paragraf 2, një votim i ri duhet menjëherë të bëhet në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje në mënyrë që të zgjedhet një këshill i ri lokal.

4. Mandati i kryetarit, dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:
   a. Me kryerje të mandatit;
   b. Nëse jep dorëheqje;
   c. Nëse ndërron vendbanim;
   d. Nëse shkarkohet; si dhe
   e. Ne rast se dënohet për vepër penale me një urdhër për burgim prej 6 muaj ose me tepër;
   f. Nëse përfshihet në strukturat udhëheqëse të subjekteve/partive politike; dhe
   g. Nëse vdes.

5. Në rast të humbjes se mandatit të kryetarit të këshillit, komisioni komunal brenda tridhjete (30) ditësh duhet të organizoj zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.

6. Zëvendësimi i anëtareve të këshillave lokal në rastin e humbjes se mandatit bëhet nga lista e pritjes me aprovimin e komisionit të kuvendit komunal brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

## Neni 7
## Procesverbali nga tubimi zgjedhor

1. Për të gjitha tubimet me qytetarë, në lidhje me zgjedhjen dhe shkarkimin e këshillave lokal, mbahen procesverbalet.

2. Procesverbali nga tubimi me qytetarë përmban: emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të komisionit komunal që udhëheqin dhe koordinojnë punën në terren për zgjidhjen e këshillave lokal, zyrtarëve komunalë, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen apo shkarkimin e këshillit lokal, procedurat e votimit dhe çështjet tjera të nevojshme që duhet të shënohen në procesverbal.

3. Procesverbalin e mban një person i caktuar nga komisioni komunal, i cili organizon tubimin.

4. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

## Neni 8
## Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokal

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

2. Së paku kryetari ose një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për hartimin e hartave zonale, dhe planeve zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.

3. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokale.

4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

**Neni 9**
**Bartja e aktiviteteve nga komuna të këshillat lokale**

1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës, Drejtorie apo komiteti të komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa detyra dhe përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të komunës.

2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal.

3. Në rast të bartjes se aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive të bartura.

**Neni 10**
**Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.

2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.

3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet ta informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.

4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

5. Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet të cilat në veçanti ndikojnë në:
   a. Zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
   b. Planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
   c. Mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;

d. Ndihmon në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
e. Siguron te dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
f. Ndihmon në mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
g. Zhvillimin e turizmit;
h. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
i. Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
j. Organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin; dhe
k. Zbaton aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

6. Këshillat lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.

7. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë organeve të kuvendit, pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e komunës brenda afatit 30 ditësh i përgjigjen këshillit lokal.

**Neni 11**
**Roli i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.

2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Po ashtu, ai i nënshkruan konkluzionet e takimeve, propozimet dhe prioritetet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit të tyre t'i dorëzojë të organet komunale, respektivisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve.

**Neni 12**
**Financimi aktiviteteve**

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plotë me statutin, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.

2. Këshilli lokal bën raporte gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuara, si dhe atyre të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti si dhe para organeve komunale.

**Neni 13**
**Kompensimi i këshillave lokale**

1. Për punën e tyre kryetaret e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës.

2. Kompensimi për kryetaret e këshillave lokale duhet të jetë ekuivalente në shumën e anëtarëve të komiteteve obligative.

3. Kompensimi në pjesëmarrje në takime behet vetëm për 6 takime të këshillave lokale të mbajtura gjatë vitit kalendarik.

4. Kompensimi nënkupton që mjetet financiare të shfrytëzohen vetëm për nevoja të funksionimit të këshillit lokal.

**Neni 14**
**Mos përmbushja e përgjegjësive**

Për të gjitha aktivitetet e bartura në këshillin lokal nga organet e komunës, këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore.

**Neni 15**
**Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare**

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e komunës, mbizotërojnë dispozitat e ligjit dhestatutit.

**Neni 16**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjte të aprovimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 17**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja nr.01-013/491 për organizmin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane në territorin e komunës së Vitisë

2. Pas miratimi nga Kuvendi i Komunës, kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë e se Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gaztën zyrtare në ueb-faqen e Komunës dhe fillon së zbatuari pas përfundimit të mandatiti të këshillave ekzistuese.

Kryetari i Komunës
Sokol HALITI

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
20-11-2020
02-035/02 1228

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, në mbështetje të nenit 6.2, të nenit 43.3 pika © dhe të nenit 80 B të Ligjit Nr,03/L-048 Për Menaxhimn e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, si dhe Rregullloren MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës, propozon këtë:

# PROPOZIM VENDIM PËR SHQYRTIMIN DHE APROVIMIN E PROPOZIM RREGULLORES PËR PËR PROCEDURAT E BRENDSHME PËR MENAXHIM TË PASURIVE JO FINANCIARE

**Neni 1**

Me këtë Vendim, Propozohet për shqyrtim dhe aprovim Rregullorja për procedurat e brendshme për menaxhim të pasurive jofinanciare

**Neni 2**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave standarde për dokumentimin, ruajtje dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare si dhe mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive jo financiare kapitale si pjesë e SIMFK-së

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Nëntor, 2020

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol HALITI

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë

Opstina Vitina

Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, në mbështetje të nenit 6.2, të nenit 43.3 pika © dhe të nenit 80 B të Ligjit Nr,03/L-048 Për Menaxhimn e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, si dhe Rregullloren MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës, propozon këtë:

# PROPOZIM RREGULLURE PËR PROCEDURAT E BRENDSHME PËR MENAXHIM TË PASURIVE JO FINANCIARE

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

### Neni 1
### Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton procedurat standardë për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jofinanciareë, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jofinanciare përmes mirëmbajtjes sistematike të Regjistrit të Pasurive Jo Financiare Kapitale si pjesë integrale e SIMFK-së dhe Regjistrit të pasurive jo Financiare jo Kapitale me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre, si dhe transparente të tjetërsimit të pasurive jo financiare

### Neni 2
### Fushëveprimi

1. Pasuria jo financiare e organizatës buxhetorenë kuptimin e kësaj Rregulloreje përfshinë të gjithë pasurinë e organizatës buxhetore që sipas klasifikimit kontabël është:

1.1. Pasuria jo financiare kapitale

1.2. Pasuria jo financiare jokapitale dhe
1.3. Stoqet

2. Klasifikimi i pasurisë jo financiare nga aspekti i menaxhimit ndahet në këto kategori:
2.1. Pasuria e cila gjendet në depon e organizatës buxhetore
2.2. Pasuria e cila është në përdorim dhe që është në pronësi të organizatës buxhetore, pavarësisht nga vendndodhja e tyre (në përdorim të personelit, brenda hapësirës punuese të organizatës buxhetore apo në hapësirën e ndonjë organizate tjetër buxhetore).

**Neni 3**
**Përkufizimet**

Të gjitha shprehjet në vijim, kudo që përdoren në këtë Rregullore kanë kuptimin e përshkruar si më poshtë, përveç në rastet kur konteksti në të cilin një shprehje e tillë shfaqet, qartë ka një kuptim tjetër:

**Buxheti i Republikës së Kosovës** – nënkupton buxhetin gjithpërfshirës të Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore, që është konsoliduar në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për financat qeveritare.
**Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare** – nënkupton komisionin e formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ/Kryetari i Komunës në organizatën buxhetore me qëllim t vlerësimit të pasurive jofinanciare.
**Komisioni për inventarizim të pasurisë jofinanciare** – nënkupton komisionin e formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ/Kryetari i Komunës në organizatën buxhetore me qëllim të inventarizimit vjetor apo periodik të psurisë jofinanciare.
**Organizatë Buxhetore** – nënkupton në autoritet publik, në tekstin e mëtëjmë "Komuna"që pranon një ndarje buxhetore
**Vlera Kontabël Neto** – kosto historike e zvogëluar për shumën e zhvlerësimit të akumuluar
**Pasuri Kapitale** – nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare materiale dhe jo materiale që blihen, ndërtohen, krijohen apo përvetësohen në ndonjë mënyrë tjetër dhe që :
**a)** Kanë afat të përdorimit më të jatë se një vit dhe që synohet të përdoren vazhdimisht
**b)** Kanë vlerë 1.000€ apo më shumë, dhe
**c)** Pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te organizata buxhetore

Pasuri jo Kapitale – nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare materiale dhe jo materiale:
a) Që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit
b) Që kanë vlerë financiare më pak se 1.000€, dhe
c) Pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet organizata bixhetore

**Stoqet** – nënkupton pasurinë jo financiare, e cila mbahet si pajisje rezervë apo material zyre e cila nuk është shpërndarë te personeli për përdorim

**Pasuri e paprekshme** – pasuria e pa trupëzuar jo financiare siç janë emri i mirë, patentat dhe licencat

**Regjistri Kontabël** – nënkupton të gjitha llogaritë financiare të organizatës buxhetore të parashikuara në nenin 43.3 (c) të Ligjit nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221. Sa i përket rexhistrit kontabël, të dhënat janë dhënë në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) për pasurinë që kanë vlerë mbi 1.000€ dhe afat të përdorimit më të gjatë se një vit, ndërsa për pasuritë jo kapitale që kanë vlerë nën 1.000€ me afat të përdorimit mbi një vit dhe stoqet janë rexhistër kontabël që i mbajnë organizatat buxhetore në "e" pasuri.

**Rexhistri i Përgjithshëm i Pasurive** – është një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive jofinanciare të zotuara nga organizatat buxhetore, pasurive jokapitale dhe stoqeve qe azhurohen rregullisht dhe që përveç përdorimit për menaxhim të pasurive do të përdoret edhe për të mbështetur të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare.

**Shpenzimet kapitale** – janë pagesa për përvetësimin e pasurive kapitale fikse, për stoqe strategjike ose emergjente, për tokë ose pasuri të paprekshme, ose pagesa të pakthyeshme me qëllim që t"u mundësohet pranuesve t"i përvetësojnë (blejnë) këto pasuri, që të kompensohen pranuesit për dëm ose shkatërrim të pasurive kapitale, ose që të rritet kapitali financiar i pranuesve, në vlerë mbi 1.000€ dhe afat të përdorimit më të gjatë se një vit.

**Zyrtar i Pasurisë** – Nënkupton zyrtarin që bënë regjistrimin e pasurisë jofinanciare dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë jofinanciare.

**Zyrtari i Pranimit/Logjistikës** – nënkupton zyrtarin i cili bën pranimin e pasurisë të kërkuar si dhe kontrollin dhe menaxhimin e stoqeve.

**Tjetërsimi i pasurisë** – nënkupton shitjen e pasurisë, dhurimin dhe asgjësimin, proces pas të cilit organizzata buxhetore nuk ka pronësi dhe mbikëqyrje mbi pronën e tjetërsuar

## Neni 4

## Përgjegjësitë

1. Zyrtari Kryesor Administrativ/Kryetari i Komunës është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare
2. Zyrtari i logjistikës paraqet pikëfillimin e regjistrimit të pranimit të një pasurie të luajtshme nga një organizatë buxhetore ku bënë pjesë edhe komuna

## Neni 4

## Regjistrimet në E-pasuri dhe Free-Balance SIMFK

1. Puna e parë të cilën e bënë ZL është regjistrimi i faturës së pranuar në librin e protokollimit të faturave hyrëse.
2. Me rastin e marrjes së faturës, ZL në të njejtën kohë merr edhe kërkesën fillestare interne, të cilat i krasahson dhe verifikon artikujt e faturuar, si dhe plotëson formularin për shërbime të mallrave të pranuara.
3. Bashkë me urdhërblerjen dhe zotimin, ZL e regjistron faturën si hyrje në programin e E-pasurisë.
4. Në rastet kur bëhet pranimi si inventar, ZL në E-pasuri e gjeneron edhe barkodin dhe e cakton në mënyrë automatike kodin përkastës. Kodi përkatës caktohet në rastet kur kemi të bëjmë me material shpenzues, ndërsa për inventar caktohen të dy, kodi dhe barkodi.
5. ZL pasi të bëjë hyrje në E-pasuri bënë hyrje edhe në Free-Balance (SIMFK), në bazë të kërkesës për blerje.
6. Në momentin e regjistrimit të pranimit dhe caktimit të barkodit, të dhënat në mënyrë automatike trasferohen të çasja e zyrtarit të pasurisë.
7. Poashtu ZL në E-pasuri e plotëson edhe fletngarkesën për zyrtarin që ngarkohet me pajisje. Ky dokument printohet nga E-pasuria dhe nënshkruhet nga ZL dhe pranuesi i pajisjes (kjo procedurë në detaje është e përshkruar te procedura e ngarkimit me pasuri).

## Neni 5

## Raportimet

Kërkesat për raportim të ZL nuk ka pasi që të gjitha informatat e nevojshme janë në dispozicion në aplikacionin E-pauria.

## Neni 6

## Detyrat e ZL pasi të bëhet inventarizimi

Një nga detyrat shtesë e ZL është edhe printimi i të gjitha barkodeve të cilat janë identifikuar që mungojnë në bazë të raportit të aprovuar të inventarizimit. Pra me rastin e përfundimit të inventarizimit, nëse janë identifikuar pasuri të cilave ju mungojnë barkode, kërkohet nga ZL që të

bëjë përsëri prinitimin e tyra në mënyrë që ato barkode pastaj të ju vendosen pasurive të identifikuara me raport. Poashtu kjo bëhet edhe me kërkesë zyrtare ku janë identifiku mungesat.

## Neni 6

## Zyrtari i pasurisë mi 1000 € dhe nën 1,000 € (ZP)

Përshkrimin e procedurave të cilat i përcjellë zyrtari i pasurisë janë të ndara në dy pjesë:

1. Procedurat e regjistrimit të pasurisë jo-kapitale
2. Procedurat e regjistrimit të pasurisë kapitale

## Neni 7

## Procedurat e regjistrimit të pasurisë jo-kapitale

Në këtë pjesë janë paraqitur procedurat për regjistrimin e pasurisë jo-kapitale në E-pasuria dhe në Free-Balance (SIMFK), varësisht nga vlera e pasurisë jo-kapitale[1].

## Neni 8

## Regjistrim i inventartit në E-pasuria

1. Pasi të pranon lënda fizikisht nga ZL dhe pasi kjo lëndë të jetë e regjistruar si pranim dhe barkoduar në E-pasuri nga ZL, ZP e fillon në E-pasuria proceduren e regjistrimit për secilin inventar që është caktuar me barkod.
2. Me këtë rast ZP ja cakton burimin financiar[2], numrin e CPO-së[3], lokacionin, datën e regjistrimit dhe e përfundon një inventar, i cili gjindet me një numër barkodi.
3. Gjatë regjistrimit i caktohet kategoria ekonomike, departamenti apo administrata ku është pasuria dhe shënohet ndonjë vërejtje eventuale. Me ketë procedurë përfundohet një artikull ose një inventar i regjistruar në E-pasuri.
4. Për secilin inventar (që është me barkod) ndodh e njejta procedurë e regjistrimit.
5. Në rast të ndonjë pajisje në vlerë mbi 1,000 EUR, ZP pasi te regjistron në E-pasuri, e regjistron në Free-Balance (SIMFK)
6. Është e preferueshme që organizata buxhetore t'i ketë të regjistruara të gjitha pasuritë në këtë aplikacion.

## Neni 9
## Regjistrimi i inventartit në Free-Balance (SIMFK)

1. Procedura e cila përcjellet për regjistrim të pasurisë në Free-Balance (SIMFK) është:
   1.1 Vendoset numri i raportit të pranimit
   1.2 Lloji i blerjes: a është blerje ndërkobëtare, vendore, donacion, përvetesim vlersim nga komisioni
   1.3 Caktohet data e pranimit
   1.4 Data e blerjes
   1.5 Caktohet lloji i entitetit: a është urdhërblerje, apo kupon shpenzimi, kupon ditor
   1.6 Pastaj ipet numri i furnitorit
   1.7 Përshkrimi i shkurtër dhe përshkrimi detaj
   1.8 Caktohet drejtorati ku bëhet pagesa
   1.9 Caktohet kodi i hyrjes së pajisjes në Free-Balance

2. Pasi të përfundojnë këto hapa, vazhdohet me procedurë të caktimit të kategorisë
   2.1 Çfarë kategorie
   2.2 Kostoja origjinale
   2.3 Caktohet vlera e mbetur
   2.4 Numri i artikullit nuk aplikohet
   2.5 Evidentimi mbi gjendjen fizike - Evidencën – a është në perdorim, në depo pra statusi
   2.6 Ipet kodi i hyrjes së pajisjes - Përvetësimi
   2.7 Institucioni
   2.8 Regjioni nuk aplikohet
   2.9 Ja japim bllokin kodues nga raporti i pranimit
   2.10 Numrin serik nese e ka
   2.11 Përshkruhet barkodi kur e ka bërë hyrje depoisti
   2.12 Emri i artikullit
   2.13 E ruan dhe ipet numri i ID-së së imventarit dhe me të gjindet në listën e Free-Balance-it (SIMFK-së)

## Neni 10

## Procedurat e regjistrimit të pasurisë kapitale

1. ZP një herë në muaj kërkon nga departamenti i financave, apo më saktësisht nga Zyrtari i Shpenzimeve (ZSH) listën e përditësuar në excel për të gjitha pasuritë apo shpenzimet kapitale[4] të realizuara.
2. ZP pasi të merr listën nga ZSH, i identifikon të gjitha shpenzimet kapitale të bëra gjatë muajit dhe fillon procedurën për marrje të informatave nga arkivisti i thesarit për secilin rast. Pastaj, merren dokumete burimore (të paraqitura në vijim) për ta regjistruar secilën pasuri kapitale të identifikuar:
   2.1 Urdhëresa për pagesë

2.2 Raporti i pranimit

2.3 Urdhër blerja

2.4 Fatura

2.5 Raporti i menaxherit

2.6 Dy fletat e para të kontratës

3. Në rast kur aplikohet, certfikata e përdorimit. Këto të gjitha merren kopje dhe regjistrohen në Free-Balance (SIMFK) me hapa në vazhdim të procedurës së regjistrimit në Free-Balance (SIMFK):

3.1 Vendoset numri i raportit të pranimit
3.2 Lloji i blerjes: a është blerje ndërkobëtare, vendore, donacion, përvetesim vlerësim nga komisioni.
3.3 Caktohet data e pranimit
3.4 Data e blerjes
3.5 Caktohet lloji i entitetit: a është urdhërblerje, apo kupon shpenzimi, kupon ditor
3.6 Pastaj ipet numri i furnitorit
3.7 Përshkrimi i shkurtër dhe përshkrimi detaj
3.8 Caktohet drejtorati ku bëhet pagesa
3.9 Caktohet kodi i hyrjes së pajisjes në Free-Balance

4. Pasi të përfundon kjo procedurë vazhdohet me procedurë për caktim të kategorisë:

3.10 Çfarë kategorie
4.2 Kostoja origjinale
4.3 Caktohet vlera e mbetur
4.4 Numri i artikullit nuk aplikohet
4.5 Evidentimi mbi gjendjen fizike - Evidencën – a është në përdorim, në depo pra statusi
4.6 I vendoset kodi i hyrjes së pajisjes - Përvetsimi
4.7 Institucioni
4.8 Regjioni nuk aplikohet
4.9 Vendoset blloku kodues nga raporti i pranimit
4.10 Numrin serik, nëse ekzistion
4.11 Përshkruhet Barkodi kur e ka bërë hyrje depoisti
4.12 Emir i artikullit
4.13 E ruan dhe i vendoset numri i ID-së së inventarit dhe më të gjindet në listën e Free-balance-it (SIMFK-së)

**Neni 11**
**Regjistrimet e pasurisë që janë në vijim**

1. Ketu vlen pothuajse e njejta procedurë si e regjistrimit të pasurive kapitale, mirëpo i vetmi dallim është se, kjo pasuri identifikohet si pasuri me kategorinë në vijim. Pra në këtë rast CPO regjistrohet si pasuri në vijim.

2. Me rastin e përfundimit të investimit fillon procedura e regjistrimit si investim i përfunduar dhe kapitalizohet. Kur i tërë projekti përfundon, atëherë për të gjitha CPO-të që janë të regjistruara në vijim të atij investimi, ZP ju drejtohet me shkresë thesarit qendror në Prishtinë, për anulimin e CPO-ve që kanë qenë në vijim e që i përkasin atij investimi.
3. Pas anulimit të tyre, ai investim regjistrohet nga fillimi si investim i kompletua,r apo si investim total, duke pasur parasysh çertifikatën e përdorimit[5].
4. Pas regjistrimit në Free Balance (SIMFK), formohet një dosje fizike e investimeve kapitale në vijim.
5. Në një dosje të investimeve kapitale duhet të jetë CPO-ja e investimit të kapitalizuar si dhe të gjitha CPO-të si investime në vijim deri sa është kapitalizuar ai investim.
6. Zyrtari i pasurisë mund ta mbajë edhe një listë interne në formen Excel, të pasurive kapitale si dhe të pasurive në vijim. Kjo për shkak se ndihmon në procesin e punës, pra të përcjelljes më të lehtë të investimeve apo dokumentacionit nga sistemi Free-Balance (SIMFK) në dosjet fizike të zyrtarit.

## Neni 12
## Regjistrimet e pasurisë të pranuara si donacion

1. Donacionet mund të jenë të natyrës jo-kapitale dhe kapitale. Te pjesa e donacioneve duhet të ekzistojë procedura për regjistrimin e donacionit si pasuri jo-kapitale dhe kapitale.

## Neni 13

## Procedura e regjistrimit të donacioneve si pasuri jokapitale

1. ZP e pranon lëndën përmes arkives së organizatës buxhetore nga drejtorati përkatës, që e ka bërë pranimin e donacionit. Në atë lëndë janë të gjitha dokumentet përcjellëse. Kjo bëhet në momentin kur pranohet donacioni, pra duhet të informohet ZP.
2. Lënda fillimisht i dorëzohet ZL për të bërë hyrje si donacion, dhe i bënë dalje apo ngarkim zyrtarit apo drejtoratit që e ka bërë pranimin e donacionin.
3. Zyrtari i pasurisë e merr lëndën dhe fillon regjistrimin e donacionit si pasuri të organizatës buxhetore.
4. Në rast se donacioni të cilin e pranon organizata buxhetore, ka vlerë të bartur regjistrohet në atë vlerë që është bartur në E-pasuri me dokumente në vijim:
   4.1 Marrveshjen e donacionit
   4.2 Faturën
   4.3 Dokumentin e pranimit ku figuron lista e donacioneve
   4.4 Nëse janë të jashtme nevojiten edhe dokumentet e doganimit sic është DUD-i[6]
5. Në rast se ai donacion nuk ka vlerë në libra, angazhohet komisioni për vlersim të pasurive për të caktuar një vlerë aktuale atyre pasurive që janë pranuar si donacion. Pas pranimit të raportit të vlerësimit nga komisioni i vlerësimit, ZP e regjistron si pasuri.

6. Nese nje inventar i pranuar si donacion ka vlerë mbi 1,000 EUR regjistrohet edhe në Free-Balance (SIMFK).
7. ZP duhet të mbajë arkivë të veçantë për donacione. Aty mbahen kopjet e të gjitha dokumenteve qe e percjellin donacionin.

**Neni 14**

**Procedura e regjistrimit të donacioneve si pasuri kapitale**

1. Për donacionet si pasuri kapitale mbahet një listë e vecantë në zyre të kryetarit, ku janë të listuara të gjitha marrëveshjet të cilat nënshkruhen si donacione direkte apo bashkëfinancime.
2. Keto marreveshje ZP i merr në rastin e nënshkrimit të kontratës. Poashtu, zyrtari njoftohet edhe për vendimin se cili zyrtar është caktuar për mbikqyerjen apo përcjelljen e këtij projekti.
3. Një menaxher angazhohet nga komuna për mbikqyrje të punimeve. Ai është i obliguar që ti ketë të gjitha dokumetet përkatëse të atij investimi: marrëveshjen, faturën, paramasën, në mënyrë që pas përfundimit të atij projekti, ZP të jetë në gjendje ti merr informatat e duhura për regjistrim të pasurisë për donacionin e dhëne si pasuri kapitale. Donacionet edhe nëse janë në vijim, dokumentacioni i ipet ZP-së në fund pasi të përfundojë dhe të pranohet si i tillë.
4. Pas përfundimit të projektit, ZP njoftohet nga mbikqyrësi i punimeve për përfundim dhe i dorëzohet një kopje e dokumentacionit.

**Neni 15**

**Procedura e regjistrimit të pasurisë si bashkëfinancim**

1. Këtu kemi kryesisht të bëjmë me bashkëfinancimet në mes të komunës dhe një ministrie apo financimet direkte nga një minstri.
2. ZP pjesën apo dokumentacionin që ka të bëjë me financim të pagesave nga komuna e merr në komunë, ndërsa pjesën tjetër që ka të bëjë me financim nga ministria e merr ne ministri përkatëse.
3.

**Neni 16**

**Transferimi i jashtëm i pasurisë**

1. Nëse kryetari merr vendim të trasferojë ose të dhurojë një organizate tjetër buxhetore një pasuri, atëherë ZP pas pranimit të dokumentacionit, përmes programit E-pasuria bënë trasferimin e pasurisë te organizatë tjetër buxhetore.

2. Nëse është pasuria në Free-Balance (SIMFK) e bënë kërkesën në thesarin qendror në Prishtinë, për trasferim të pasurisë organizatës tjetër për qëllim të çregjistrimit të asaj pasurie nga regjistri i pasurive.

### Neni 17
### Raportimet

1. ZP për çdo kërkesë është në gjendje të nxjerrë një listë të veçantë, pra të gjenerojë listën nga sistemi E-pasuria për pasuritë që është i ngarkuar secili zyrtar.
2. Në rast nevoje zyrtari i pasurisë është i gatshëm të raportoj për gjendjen faktike të pasurisë kapitale dhe jo-kapitale.
3. Në përfundim të vitit fiskal (raportim të pasqyrave financiare) ZP i përgatitë raportet e pasurisë kapitale dhe jo-kapitale në verzionin PDF, si dhe një listë të vecantë në verzionin Excel të ndarë nëpër kategori si pasuri kapitalet dhe jo kapitalet dhe i dorëzon Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF-së) apo Shefit të Buxhetit (SHB).

### Neni 18
### Zyrtari i shkarkimit (ZSHK)

1. ZSHK është zyrtari i involvuar në procesin e trasferimit të brendshëm të pasurive. ZSHK përmes E-pasurisë bënë shkarkimin e inventarit apo pasurisë, për zyrtarin që ka bërë kërkesë dhe ajo pasuri fizikisht mirret dhe dërgohet në depo për grumbullimin e pasurisë së dëmtuar dhe jashtëpërdorimit. Në këtë moment ngarkohet zyrtari që është përgjegjës për depo. Si dëshmi ipet një dokument shkarkimi dhe një mbetet në dosje të ZSHK-së.
2. ZSHK është i obliguar që të mbajë një evidencë apo listë të vecantë me evidencë për inventar që zyrarët shkarkohen, ku në rast të një vendimi të kryetarit për shitje apo asgjesim të atij inventari jashtë përdorimit, ajo listë i dorëzohet zyrtarit të pasurisë për përfshirje të atyre aseteve.
3. Në rastin e grumbullimit të një sasie të caktuar në depo të shkarkimit, ZKSH përmes programit E-pasuria e ka mundësinë që ta gjeneroj një raport të asaj pasurie që gjendet në depo të shkarkimit.
4. Me qëllim që të fillojë procedura e asgjesimit, shitjes apo faljes ose dhurimin, ZSHK ju drejtohet me shkresë Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA), komisionit për vlerësim dhe ZP-së.
5. Çdo tremujor ZSHK nxjerrë raport dhe i drejtohet komisionit për vlerësim të pasurisë dhe ZP-së për vlerësimin e asaj pasurie që gjindet në depo të shkarkimit.
6. Pas vlerësimit komisioni i propozon kryetarit çka të bëhet me atë pasuri.
7. Kyetari merr vendim për atë pasuri.
8. Pas vendimit ZSHK i drejtohet ZP-së për ta hequr pasurinë nga regjistri pasi që është asgjesuar apo shitur.
9. Komuna duhet të caktojë një lokacion të caktuar për grumbullimin e inventarit që është jashtë përdorimit. Për çdo pasuri të larguar nga përdorimi e që kalon përmes ZSHK duhet fizikisht të dërgohet në depo. ZSHK është zyrtari i cili menaxhon apo që është përgjegjës për inventarin i cili është në depon e cekur më lartë.
10. Pas grumbullimit të një sasie të caktuar në depo të shkarkimit, ZSHK i propozon me shkrim ZKA-së, që të filloj procedurën e vlerësimit përmes komisionit për vlerësim të pasurive.

11. Pas tjetërsimit të pasurive përmes shitjes apo asgjesimit sipas vendimit të komisionit, inventari çregjistrohet nga kartela e ZSHK që menaxhon me pasuri në depo.

## Neni 19
## Ngarkimi dhe shkarkimi i zyrtarit si dhe procedura për ngarkim me pajisje ose pasuri

1. Procedura e ngarkimit me inventar fillon kur ZL-ja dorëzon pasurinë zyrtarit qe ka bërë kërkesë për blerje. Ngarkimi i zyrtarit që pranon pasurinë bëhet në E-pasuri nga ana e ZP-së.
2. Gjenerohet forma dhe të dhënat që paraqiten në dokumentin e ngarkimit janë:

2.1 Të dhënat për zyrtarin përfshirë edhe pozitën dhe departamentin
2.2 Data kur ngarkohet
2.3 Personi qe e ngarkon
2.4 Emri dhe përshkrimi i pajisjes, përfshirë kodin, datë kur është dhënë pasuria, sasinë dhe ndonjë verejtje
2.5 Nënshkrimi i personit qe e pranon pasurinë
2.6 Nënshkrimi i personit qe e autorizon
2.7 Nënshkrimi i personit qe e dorëzon (ZP)

3. Në E-pasuri mbahet evidencë e secilit zyrtar për pasuritë me të cilat ngarkohet.
4. Në momentin kur shtohet ndonjë pasuri gjenerohet forma dhe zyrtari që ngarkohet duhet ta nenshkruaj atë.
5. Një herë në vit, me rastin e inventarizimit verifikohet a është lista e ngarkimit të zyrtarit e plotë.

## Neni 20

## Procedura për shkarkim me pajisje ose pasuri

1. Çdo zyrtar që e sheh të arsyshme një transferim të brendshëm i drejtohet me shkresë përmes arkives zyrtarit të shkarkimit për të transferuar një pasuri prej një zyrtari në një zyrtar tjetër brenda një organizate buxhetore. Pas pranimit të shkresës zyrtari i shkarkimit përmes E-pasuri-së bënë transferimin prej atij personi që ka bërë kërkesë te zyrtari tjetër.
2. Nga programi gjenerohen dy raporte të transferimit të brendshëm dhe në atë dokumen nënshkruajnë dy zyrtarët, ai që e dorëzon dhe ai që e pranon mallin. Një kopje i lihet zyrtarit që ka bërë kërkesë dhe tjetra në dosje të zyrtarit shkarkues.
3. Poashtu, për ndonjë inventar që është i dëmtuar apo jashtë përdorimit, zyrtari që është i ngarkuar për atë inventar, bënë kërkesë nëpërmjet arkives zyrtarit të shkarkimit, për shkarkim të atij inventari.
4. Përgatitet dokumenti për shkarkim i cili përmban këto informata:
    4.1 Të dhënat për zyrtarin përshirë edhe poziten dhe departamentin
    4.2 Data kur shkarkohet
    4.3 Personi që e shkarkon

4.5 Emri dhe përshkrimi i pajisjes, përfshirë kodin, datën kur është dhënë pasuria, sasinë dhe ndonjë vërejtje

4.6 Nënshkrimi i personit që e pranon pasurinë

4.7 Nënshkrimi i personit që e autorizon

4.8 Nënshkrimi i personit që e dorëzon (zyrtari i pasurisë)

5. Në rast se zyrtari ka ende pajisje atëhere, dokumenti për shkarkim i bashkangjitet dosjes së zyrtarit ku mbahet evidencë për të gjitha pajisjet me të cilat momentalisht është i ngarkuar.

## Neni 21

## Procedura e dërgimit të pasurisë në servisim

1. Duhet të plotësohet formulari për dërgim të inventarit në servisim.
2. Formulari mbahet te departamenti i TI-së, i cili është përgjegjës për plotësimin e tij dhe nënshkrimin e dyanshëm me rastin e marrjes së pajisjes. Një kopje mbetet tek zyrtari të cilit i merret pajisja.
3. Afati i servisimit nuk duhet të kaloj një muaj.
4. Nëse pajisja brenda muajit nuk kthehet te zyrtari, pajisja mund të hyjë në procedurë të shkarkimit dhe në të njejtën kohë ngarkohet zyrtari i TI-së i cili edhe e ka pajisjen në servisim.
5. Me rastin e inventarizimit, nëse pajisja mungon për shkak se është në servisim, atëherë zyrtari duhet ta dëshmojë mungesën e inventarit me dokument (formular) të servisimit të pajisjes. Nese nuk e ka atëherë përgjigjet edhe financiarisht për pajisje.
6. Zyrtari i TI-së në baza mujore duhet të raportoj te Zyrtari i Administratës për pajisjet që janë në servisim.

## Neni 22

## Procedurat për shkarkim me pajisje kur puntori e shkëput marrdhënien e punës

1. Përgatitet dokumenti për shkarkim i cili përmban këto informata, të cilat janë të njejta si në procedurë kur shkarkohet me pajisje.
2. Përveç kësaj, shiqohet se a ka obligime të tjera punëtori siç janë:

   2.1 Obligimet në drejtim të financave – ndonjë avans

   2.2 Obligimet në drejtim të resurseve njerzore – ID-në, lejen e vetures etj

   3.3 Obligimet në drejtim të përdorimit të softëare-ave siç janë: passëord-at, kodet e hyrjes etj.

4. Pasi të verifikohen të gjitha këto aprovohet dokumenti për shkarkim dhe dërgohet për procesim.

## Neni 23

### Procedurat e regjistrimit fillestar të pasurive (organizata që fare nuk i kanë të identifikuara dhe regjistruara pasuritë)

1. Për të përmirësuar/regjistruar listën e pasurisë së komunës, duhet ndjekur disa hapa:
   1.2 Identifikimi i të gjitha aseteve në dispozicion të komunës (të reja dhe të vjetra)
   1.2 Formimi i një komisioni që:
      1.2.1 Bënë regjistrimin e tërë pasurisë së komunës duke përfshire edhe infrastrukturën dhe tokat
      1.2.2 Nëse nuk ka evidencë për pronat që ka komuna, mund të përdoret modeli i komunës së Prishtinës për evidentim, Manuali per evidentim të pronave komunale, udhëzuesi për komuna
2. Pasi të përfundohet me regjistrim duhet të kontrollohen dokumentet burimore për pasurinë e identifikuar:
   2.1 Fatura
   2.2 Pranime
   2.3 Dëshmi pronësie
   2.3 Kontrata të donacioneve
   2.4 Evidence të ndryshme në bazë të së cilës identifikohet vlera
3. Fillon regjistrimi i aseteve kapitale në Free-Balance (SIMFK). Poashtu regjistrohen asetet kapitale dhe jo-kapitale në E-pasuria.
4. Idenfikohet pasuria për të cilat nuk ekziston evidencë
5. Pronat apo tokat
6. Objektet e vjetra
7. Pasuritë si donacione
8. Ndonjë pasuri tjetër e vjetër
9. Për pasuritë që nuk kanë dokumete burimore duhet të kalohet në porcedurën e vlerësimit të tyre apo përcaktimit të vlerës.

9.1 Procedura:

9.2 Krijohet komisioni për vlerësim të pasurive pa dokumete burimore
9.3 Së paku tre anëtarë

9.4 E preferushme një anëtar i komisionit te jetë vlerësues profesional i patundëshmërive

10.Vlera përcaktohet:

10.1Duke u bazuar ne zonën kadastrale që bënë pjesë prona
10.2Duke shiquar së paku tri shitblerje që janë bërë në atë zonë
10.3Apo duke kryer së paku tri intervista me banorë në atë zone

11.Komisioni përgatit raportin për pasurite e vlerësuara. Raporti duhet të aprovohet nga nivelet me të larta komunale.

12. Ne bazë të këtij raporti bëhet regjistrimi i pronave në E-pasuria dhe në Free-Balance (SIMFK) nga ana e zyrtarit të pasurisë.

**Neni 24**

**Procedurat e inventarizimit të pasurive**

1. Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Inventarizimi i pasurisë jo financiare duhet të kryhet sipas dispozitave të rregullores 2/2013 dhe procedurave të brendshme të miratuara nga Zyrtari Kryesor Administrativ
2. Komuna duhet të kontrollojë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare.
3. Zyrtari Kryesor Administrativ/Kryetari i Komunës kur ka dyshime për mashtrime, keqpërdorim, vjedhje apo humbje të pasurisë jo financiare duhet të merre vendime për inventarizimin e pjesshëm apo të tërësishëm kurdo që konstatohet një gjendje e tillë.

4. Aktivitetet që i paraprijnë inventarizimit janë:
   4.1 Vendimi për inventarizim të pasurisë
   4.2 Emërimi i Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare
   4.3 Udhëzimi i brendshëm mbi inventarizimin e pasurisë;

**Neni 25**

**Procedurat e brendshme mbi inventarizimin e pasurisë**

1. Zyrtari kryesor administrative/Kryetari i Komunës, merr vendim për inventarizim e pasurive jo Financiare dhe cakton komisionin (si organ të përkohshëm) më së largu deri më 31 Tetor të secilit vit fiskal
2. Caktimi i komisionit bëhet me vendim në të cilin përmenden pikat në vijim:
   a. Ligjet dhe rregulloret në bazë të cilës caktohet komisioni
   b. Kush do të jenë anëtar të komisionit (së paku tre anëtar)
   c. Detyrat e komisionit
   d. Afatet kohore kur duhet të kryhet inventarizimi
   e. Kujt duhet dorëzuar raportin
   f. Kujt i shpërndahet ky vendim
3. Anëtarëve të komisionit u dorëzohet rregullorja e brendshme e komunës ku përshkruhen hapat që duhet përcjellur për inventarizim
4. Përgjegjësitë e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare janë si në vijim:
   a. Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të komunës;
   b. Verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare;
   c. Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare;
   d. Identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur;
   e. Identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit;

    f. Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit;
5. Bëhet plani kohor për rrjedhën e punës së inventarizimit
6. Në plan kohor ceket se inventarizimi duhet të përfundoj më së largu deri me datë 15 janar të vitit vijues
7. Raporti final duhet të dorëzohet më së largu deri me 20 janar të vitit vijues
8. Përveç afatit kohor bëhet edhe plani i vizitave në secilin departament dhe objekt të komunës
9. Pasi të bëhet plani njoftohet secili departament se kur do vizitohet nga komisioni me qëllim të inventarizimit
10. Njoftimi duhet të bëhet së paku një javë para vizitës
11. Çdo departament apo përgjegjës zyre ose objekti ka për detyrë të caktoj një person që do i asistoj apo përgjigjet kërkesave të komisionit gjatë inventarizimit
12. Me rastin e përpilimit të planit zyrtari i pasurisë u dorëzon komisioneve listën e inventarit që ekziston në secilin departament, zyre ose objekt që do të vizitohet nga komisioni
13. Me rastin e vizitës për inventarizim komisioni verifikon informatat në vijim:
    a. Shënohen të gjitha asetet që janë prezentë në vendin e vizituar
    b. Verifikohet a kanë numër serik / barkod
    c. Verifikohet gjendja e aseteve, a është e rregullt
    d. Si dhe a janë duke u përdorur
14. Pasi të bëhet numërimi në atë departament, zyre apo objekt komisioni e merr nënshkrimin nga përgjegjësi i atyre aseteve, në mënyre që të dëshmohet vizita fizike në atë departament, zyre apo objekt
15. Pasi të përfundohen vizitat fillon krahasimi i të dhënave të marra me të dhënat në regjistrin e pasurisë
16. Identifikohen dallimet si në vijim:
    a. Mungesat e aseteve
    b. Asetet që janë në gjendje jo të rregullt apo të dëmtuara
    c. Asetet që janë në gjendje të rregullt po nuk përdoren
    d. Asetet që janë në servisim
17. Pastaj fillon përpilimi i raportit në të cilën shënohen informatat e mësipërme në detaje për secilin departament, zyre apo objekt. Hartimi i raportit të përgjithshëm bëhet në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurisë jo jofinanciare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara;
18. Raporti i përfunduar dhe i nënshkruar nga zyrtarët e komisionit dorëzohet te personat përgjegjës: ZKA, ZKF dhe Drejtori Financiar
19. Caktohet edhe koha kur do të diskutohet raporti me personat përgjegjës
20. Personat përgjegjës duhet pastaj të marrin vendim për hapat e mëtutjeshëm në bazë të rezultateve të raportit:
    a. Të kërkoj përgjegjësi për asetet që mungojnë
    b. Të nis procedurën e vlerësimit të aseteve që janë në gjendje të rregullt por nuk përdoren, apo aseteve që nuk janë në gjendje të rregullt

21. Për të gjitha hapat dhe vendimet e marra njoftohet zyrtari i pasurisë, I cili pastaj vepron, intervenon dhe e azhurnon e regjistrin e pasurisë duke u bazuar në këto vendime

**Neni 26**

**Procedurat e vlerësimit të pasurive**

1. Zyrtari Kryesor Administrativ themelon Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare. Komisioni për Vlerësim e Pasurisë jo Financiare është një organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare përbëhet së paku nga tre anëtarë që janë zyrtar të organizatës buxhetore.
2. Në raste kur kemi të bëjmë me pasuri specifike që me rastin e vërtetimit të saktësisë dhe cilësisë të pasurisë që inventarizohet, në mungesë të ekspertit nga organizata buxhetore anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Pasurive jo Financiare mund të caktohet edhe ndonjë zyrtar i ndonjë organizate tjetër buxhetore apo ekspert i jashtëm.
3. Aktivitetet që i paraprijnë vlerësimit:
    1. Vendimi për vlerësim të pasurisë
    2. Emërimi i Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare
    3. Udhëzimi i brendshëm mbi vlerësimin e pasurisë.

**Neni 27**

**Procedurat e brendshme mbi vlerësimin e pasurisë**

1 Zyrtari Kryesor Administrativ/Kryetari i Komunës duke ju referuar raportit të inventarizimit merr vendim për themelimin e Komisionit për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare.

2 Caktimi i komisionit bëhet me vendim në të cilin përmenden pikat në vijim:
   a. Ligjet dhe rregulloret në bazë të cilës caktohet komisioni
   b. Kush do të jenë anëtar të komisionit (së paku tre anëtar)
   c. Detyrat e komisionit
   d. Afatet kohore kur duhet të kryhet vlerësimi
   e. Kujt duhet dorëzuar raportin
   f. Kujt i shpërndahet ky vendim

3 Anëtarëve të komisionit u dorëzohet rregullorja e brendshme e komunës ku përshkruhen hapat që duhet përcjellur për vlerësim të aseteve inventarizim

4 Ky komision ka për detyrë të bëjë vlerësimin e pasurisë së identifikuar si pasuri në gjendje të rregullt por që nuk është duke u përdorur, apo vlerësimin e pasurisë së dëmtuar apo jashtë përdorimi dhe në bazë të vlerësimit të jap rekomandime si në vijim:
   a. Pasuria të transferohet në ndonjë departament tjetër të komunës që ka nevojë për aset të tillë
   b. Të kaloj në procedura të shitjes
   c. Ti falet ndonjë organizate në nevojë
   d. Të asgjësohet

5 Komisioni informohet për asetet që duhet vlerësuar

a. Lloji i aseteve
b. Ku gjinden ato
c. Kur mund të vizitohen fizikisht

6 Komisioni bënë vizitën në zyrën, departamentin apo objektin ku gjinden këto asete
7 Varësisht nga konstatimi i gjendjes përpilon raportin i cili përmban njërin prej rekomandimeve në vijim
   a. Nëse konstaton që aseti është ende i përdorshëm për nevoja komunale propozon që ky aset të përdoret në ndonjë departament tjetër
   b. Nëse vlerëson se aseti ka vlerë, pra është në gjendje të rregullt, mirëpo nuk mund të përdoret nga ndonjëri prej departamenteve propozon që të kaloj në procedura të shitjes apo të faljes ndonjë organizate tjetër
   c. Nëse konstaton që aseti nuk është me i përdorshëm propozon qe aseti të asgjësohet
8 Raporti i përfunduar dhe i nënshkruar nga zyrtarët e komisionit dorëzohet te personat përgjegjës: ZKA, ZKF dhe Drejtori Financiar
9 Në bazë të rekomandimeve në raport, ZKA merr vendim për hyrje në procedure të tjetërsimit të pasurisë

## II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 28
### Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore do të aplikohet deri sa të jetë në fuqi Rregulllorja e Ministrisë së Financave nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore
2. Për zbtimin e kësaj Rregulllore do të Kujdeset Kryetari I Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
3. Rregullorja hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

**Nëntor, 2020**

**Kryetari i Komunës**

**Sokol HALITI**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
24-11-2020
02-035/02-1240

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROPOZIM RREGULLORE

## PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-920, E DT.01.10.2020

VITI, 24.11.2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 9 dhe 13 të ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, me kërkesën e MAPL-së Nr.43-734/1 te datës 16.10.2020 Kryetari i Komunës paraqet këtë:

# PROPOZIM RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-920, E DT.01.10.2020

## Neni 1

Kjo rregullore ka për qellim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-920, të datës 01.10.2020, me kërkesën e MAPL-se Nr.43-734/1 te datës 16.10.2020

## Neni 2

Te rregullorja bazë, neni 5.1, Lëshimi i certifikatës se lindjes, ekstrakti te lindjes, martesës duhet të përmisohet të jete **Çertifikata e lindjes, ekstrakti nga Regjistri Qendror i gjendjes civile dhe çertifikata e martesës,**

Pika 5.2, Lëshimi i çertifikates mbi statusin martesor duhet te përmisohet të jete **Çertifikatë e gjendjes martesore.**

**Pika 5.7,** Lëshimi i çertifikatës familjare duhet të përmisohet në **Deklaratë për bashkësinë familjare.**

Pika 5.13, Vendimi mbi regjistrimi e me vonshëm në LAL, LAM DHE LAV dhe te tjera ku çmimi është 3.00€, të permisohet në **Regjistrimi i fëmijës me vonesë, pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh çmimi është 20.00€.**

Kërkohet të inkorporohet **Regjistrimi i vdekjes me vonesë, pas kalimit te afatit ligjor prej 30 ditësh çmimi 50.00 €.**

**Ndërsa pika 5.15 e rregullore baze tërhiqet krejtësisht.**

## Neni 3

Te rregullorja bazë, neni 11, duhet të fshihen krejtësisht Vërtetimi për shitjen e prodhimeve bujqësore i cili kushtojnë 10€.

Ndërsa tek ky nene me kërkesën e Ministrisë duhet të shtohen:

**Shërbimet profesionale për prerjen të pyjeve private:**

- a.) Dru Zjarri mbi 7 m$^3$........................1.50 €
- b.) Dru Zjarri për m$^3$..............................2.00 €
- c.) Dru Teknik m$^3$.................................2.50 €

**Taksa për kullotjen e begëtisë për një (1) vit;**

- a.) Gjedhe mbi një vjet .....copë......1.20€
- b.) Viçat .............................copë 0.80€
- c.) Delet .............................copë 1.20€
- d.) Qengjat ..........................copë 0.80€
- e.) Kuajt dhe gomarët....copë 1.90€
- f.) Derrat .......................copë 1.60€
- g.) Derrkucat ..................copë 0.90€

## Neni 4

Te rregullorja baze neni 24, të hyrat nga shendesia janë të hyra nga bashke pagesat te cilat realizohen ne pajtim me udhëzimin administrativ 04/2007 dhe 04/2011 të Ministrisë se Shendesisë,

këtu duhet të permisohet udhëzimi administrativ 04/2011 të zëvendësohet **me udhëzimi administrativ 04-2013.**

**Neni 5**

Te rregullorja baze neni 40.2. Me gjobë prej 4 € për m$^2$ deri me 6 € m$^2$ do të dënohen personat juridik dhe fizik qe veprojnë ne kundërshtim me nenin 12.1.3 dhe 12.1.4 te kësaj rregullore duhet tw permisohet **Me gjobe prej 10 € deri 50 € per personat fizik , për personat fizik që ushtron biznes individual 30 € deri 70 € ndersa personat jurdik 30 Euro deri 150 € qe veprojne ne kundershtim me nenin 12.1.3 dhe 12.1.4**, dhe

Pika 40.3 Me gjobë prej 30 € deri 50 € do të dënohen personat juridik dhe fizik qe veprojnë ne kundërshtim me nenin 13.2.8 pika a),dhe neni 13.2 9 pika a),b),c),d) të kësaj rregullore duhet tw permisohet **Me gjobe prej 20 € deri 50 € per personat fizik , për personin fizik që ushtron biznes individual 30 € deri 80 € ndersa personat jurdik 40 Euro deri 150 € qe veprojne ne kundershtim me nenin 13.2.8 pika a) dhe neni 13.2.9 pika a), b), c),d).**

**Neni 6**

Pjesët tjera të rregullores baze mbesin të pa ndryshuara.

**Neni 7**

Kjo propozim rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit te akteve te Komunave dhe pas publikimit në Web faqen

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno 16-11-2020
Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
02-035/02-1205

Komuna Vitisë
OpstinaVitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligji mbi Vetëqeverisjën Lokale Nr.03/L-040 lidhur me nenin 50 paragrafi 1 pika h të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të dates 21.04.2011 , në harmoni me dispozitt ligjore të nenit 19 të Ligjit mbi Gjuetinë Nr.02/L-53 në harmoni me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009 për dhënjën në menaxhim të vendgjuetive të përbashkta, Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve që ja lejon ligji paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM**

**Për themelimin e vendgjuetisë së përbashket në Komunen e Vitisë**

**Neni 1**

Me këtë propozim vendim Kryetari i Komunës propozon që me qëllim të rritjes, kultivimit, mbrojtjës , shfrytëzimet të kafshëve të egra dhe menaxhimit më të mire të tyre ,themelohet kjo vendgjueti.

**Neni 2**

Me këtë propozim vendim emertohet vendgjuetia "**Kopilaqa**"

**Neni 3**

Vendgjuetia Kopilaqa shtrihet në pjesën jugore të Kosovës buzë kufiriti shtretror me Republikën e Maqedonis së Veriut , i takon masivit të pyjeve të Karadakut të Shkupit , kryesisht shtrihet në pjesën veriore.

**Neni 4**

Emertimi i vendgjuetisë është bërë nga maja më lartë me lartësi nbidetare 479-1492 m me sipërfaqe prej 6176.75 ha pastaj në pjesën veriore vazhdon në zonën e pyjeve Zhegovci që shtrihet në lartësin mbidetare 479-830 m me sipërfaqe prej 1392.47 ha që kufizohet me Komunën e Gjilanit dhe Ferizajit ,ndërsa në pjesën perindimore kufizohet me pyjet e zonës menaxhuese Goshica e cila shtrihet në lartësi mbidetare prej 560-941 e cila ka sipëfaqe 2764.93 ha pyje dhe toka pyjre e cila kufizohet me Komunën e Kaqanikut .

**Neni 5**

Qetësia në vendgjueti është në nivelin e duhur që ju mundëson të jetë e qetë të gjitha egërsirave në teren.

**Neni 6**

Ky propozim vendim hynë fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

\

Propozues :Kryetari i Komunës

Z.Sokol Haliti

Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 4257/2
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 2
Data/Datum/Date: 09.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

**MINISTRIA E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**
**MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE. SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA**
**MINISTRY OF AGRICULTURE,FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

**DEPARTAMENTI I PYLLTARISË / DEPARTMENT SUMARSVA/ FORESTRY DEPARTMENT**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| REFERENCË: | | 05/ 94/ 2020 | | | |
| PËR/ZA/TO: | | z. Bekim Hoxha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm ne MBPZHR; | | | |
| CC: | | | | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | | z. Tahir Ahmeti, Drejtor i Departamentit te Pylltarisë; | | | |
| NGA/OD/FROM: | | z. Bajram Batusha, kryesues Komisioni për vlerësimin e kërkesave | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | | Propozim për dhënie të pëlqimit për Themelim të Vendgjuetisë së Përbashkët në komunën e Vitisë | | | |
| Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.: | 310 | Lokacioni: Kucni: Extension: | | Data: Datum: Date: | 05.11.2020 |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | | | | | √ |
| PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE | | | | | √ |
| PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS | | | | | √ |
| A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS | | | | | ☐ |
| VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION | | | | | ☐ |
| SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED | | | | | ☐ |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | | | | | ☐ |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | | | | | ☐ |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | ☐ |
| AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE | | | | | |

**I nderuar z. Sekretar;**

Mbështetur në Ligjin për Gjuetinë Nr. 02/L - 53, neni 19.2 për Themelimin e Vendgjuetive të Përbashkëta dhe Udhëzimit Administrativ MA-Nr. 10/2007, Kriteret e Caktimit të Zonave dhe Procedurat për Themelimin e Vendgjuetive, si dhe neni 34 i këtij ligji dhe në bazë të kritereve të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2009 Për dhënie ne menaxhim te vendgjuetive te përbashkëta.

Komisioni i formuar me Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm me Ref. ZSP.909/20, Nr.700, paragrafi 2.1 të datës 18.09.2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin Vendimit të SP me Ref. ZSP.191/2020 Nr.138 te datës 18.03.2020, në takimet e radhës te mbajtura me datën 30.10.2020 beri shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës Nr.4257/13 të dt.28.10.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të komunës se Vitisë për dhënien e pëlqimit për themelimin e Vendgjuetise së Përbashkët. Komisioni shqyrtoi lëndën duke u bazuar në Nenin 19.2 të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L-53 dhe dispozitat e përcaktuara të UA. MA-Nr. 10/2007 Kriteret e Caktimit te Zonave dhe Procedurat për Themelimin e Vendgjuetive.

Komision në përbërje të plotë nga Bajram Batusha, kryesues, Kemajl Kadriu, anëtar dhe Shyhrete Bunjaku, anëtare, mbajti takimin e radhës me datën 30.10.20, ku beri shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës se komunës se Vitise, Nr.4257/13 te datës 28.10.2020 për dhënien e pëlqimit për themelimin-rithemelimin e vendgjuetisë të përbashkët të emërtuar ''Kopilaqa''me sipërfaqe të përgjithshme prej 26993.59 ha dhe sipërfaqe ku munde të kryhen aktivitete gjuetie prej 23120.70 ha.

Arsyeshmëria për rithemelimin e kësaj vendgjuetie (sipas kërkesës në fjalë) është mos zbatimi i Pëlqimit për themelimin e vendgjuetisë se përbashkët të emërtuar ''Vitia'' Nr.1991 të datës 22.09.2008, dhe Pëlqimit Nr. 796 i datës 26.03.2010, për dhënie në menaxhim të Vendgjuetisë së Përbashkët "Vitia" të nxjerrë nga MBPZHR-ja, që do të thotë organet kompetente komunale nuk i kanë zbatua kriteret e Ligjit për Gjuetinë dhe Udhëzimeve Administrative të dala nga ky ligj.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit te dokumentacionit baze komisioni konstatoj;
Kërkesa dhe dokumentacioni i vlerësuar nga komisioni është ne harmoni me legjislacionin ne fuqi dhe propozon dhënien e pëlqimit per themelimin –rithemelimin e vendgjuetise se përbashkëta''Kopilaqa'' ne komunën e Vitise.
Bashkangjitur këtij akti përcjellës është kërkesa me dokumentacionin përcjellës dhe propozim Pelqimi.

Respekt;

Komisioni:

1. Bajram Batusha, kryesues;
2. Kemajl Kadriu, anëtar dhe
3. Shyhrete Bunjaku, anëtare.

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 4257/3
Nr. 2
Data/Datum/Date: 09.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria -Vlada - Government**

***Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development***

***Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm -Kancelarija Generalnog Sekretara- Office of the Secretary General***

Datë: 05.11.2020
Ref. ZSP. 1047

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 15 (Shtojca 2) të Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08 qershor 2020), si dhe në bazë të nenin 19 paragrafi 19.2 të Ligjit Nr.02/L-53 Për Gjuetinë (GZ, nr.8/01 Janar 2007 dhe nenit 8 paragrafi 8.1, 8.4 dhe 8.5 Udhëzimit Administrativ NR.10/2007 Kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive, dt. 14/09/2007, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nxjerr:

# P Ë L Q I M

## PËR THEMELIMIN - RITHEMELIMIN E VENDGJUETISË TË PËRBASHKËT NË KOMUNËN E VITISË

1. **Jepet PËLQIMI** për themelimin – rithemelimin e vendgjuetisë së përbashkët **"Kopilaqa"** në territorin e Komunës së Vitisë me sipërfaqe të përgjithshme prej 26993.59 ha dhe me sipërfaqe prej 23120.70 ha ku mund të kryhen aktivitete të gjuetisë, sipas hartës dhe dokumentacionit të kompletuar, bashkangjitur kërkesës për dhënien e Pëlqimit për Themelimin e Vendgjuetisë së Përbashkët.

2. Vendgjuetia e përbashkët nga pika 1 e këtij Pëlqimi, me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe rregullimit të tyre në aspektin administrativ, duhet të jetë e qëndrueshme e shfrytëzuar sipas tërësisë së ekosistemit, baraspeshës ekologjike, kultivimit, mbrojtjes, dhe shtimit të kafshëve të egra si pasuri natyrore kombëtare me interes të përgjithshëm që gëzon mbrojtje të veçantë në harmoni me nenin 19 paragrafi 19.2 dhe të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë, (GZ. Nr.08, dt.01.01.2007) dhe nenit 8 paragrafi 8.1, 8.4 dhe 8.5 Udhëzimit Administrativ NR.10/2007 Kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive, dt. 14/09/2007.

3. Arsyeshmëria për rithemelimin e kësaj vendgjuetie (sipas kërkesës në fjalë) është mos zbatimi i Pëlqimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët të emërtuar **''Vitia''**

Nr.1991 te datës 22.09.2008, dhe Pëlqimit Nr. 796 i datës 26.03.2010, për dhënie në menaxhim të Vendgjuetisë së Përbashkët "Vitia" të nxjerrë nga MBPZHR-ja, që do të thotë organet kompetente komunale nuk i kanë zbatua kriteret e Ligjit për Gjuetinë dhe Udhëzimeve Administrative të dala nga ky ligj.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij Pëlqimi Shfuqizohet Pëlqimi për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët të emërtuar **"Vitia"** me Nr.1991 të datës 22.09.2008, dhe Pëlqimi Nr. 796 i datës 26.03.2010, për dhënie në menaxhim të Vendgjuetisë së Përbashkët "Vitia" të nxjerrë nga MBPZHR-ja.

5. Obligohet Drejtoria Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e komunës se Vitise, për zbatimin këtij pëlqimi sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

6. Pëlqimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në autorizimet ligjore në fuqi, nenin 19.paragrafi 19.2 të Ligjit Nr.02/L-53 Për Gjuetinë (Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr.08, dt.01.01.2007), nenit 8 paragrafi 8.1, 8.4 dhe 8.5 Udhëzimit Administrativ NR.10/2007 Kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive, dt. 14/09/2007, me qëllim të organizimit dhe mbarëvajtjes së punëve për themelimin - rithemelimin e vendgjuetisë së përbashkët, "Kopilaqa", në bazë të kërkesës për dhënien e pëlqimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët Nr.4257/13, të dt. 28.10.2020, të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të komunës së Vitisë, pas shqyrtimit të kërkesës, shkresave të lëndës dhe propozimit të dhënë nga komisioni për dhënien ose refuzimin e pëlqimit për themelimin e vendgjuetive të përbashkëta në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vendosi që të jep Pëlqimin për themelimin e Vendgjuetisë të përbashkët në territorin e komunës së Vitise me sipërfaqe të përgjithshme prej 26993.59 ha, dhe sipërfaqe prej 23120.70 ha ku mund të kryhen aktivitete të gjuetisë, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij pëlqimi.

Bekim Hoxha

Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

*Pëlqimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit të Pylltarisë;*
- *Agjencisë Pyjore të Kosovës;*
- *Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit;*
- *Komuna e Vitisë – Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;*
- *Arkivit.*

ORIGINALI

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno | 17/11/2020 | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 10/035/02-120 | | | |

**Republika e *Kosovës***
*Republika Kosova*
*Republic of Kosovo*

*Komuna e Vitisë*
*Opstina Vitina*
*Municipality of Viti*

***Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural***

*PROJEKT PROPOZIM PËR THEMELIMIN E VENDGJUETIS SË PËRBASHKËT NË KOMUNËN E VITISË*

***VITI 2020***

## *Përmbajtje:*

*Korniza ligjore*

*Hyrje*

*1.Shënime të përgjithshme për vendgjuetinë....................................................1*

*1.1.Konfiguracioni I terenit.....................................................................2*

*1.2.Karakteristikat pedologjike...............................................................2*

*1.3.Kushtet hidrografike.........................................................................2*

*1.4.Infrastruktura ë vendgjuetisë............................................................3*

*1.5.Qetësia në vendgjueti.......................................................................3*

*1.6.Ndikimi antropogjen.........................................................................3*

*1.7.Kushtet klimatike.............................................................................4*

*1.8.Vegjetacioni  në vendgjueti...............................................................4*

*1.9.Ushqimi plotësues I egërsirave..........................................................4*

*2.Shënimet themelore për vendgjuetinë....................................................5*

*2.1.Struktura e sipërfaqes në vendgjueti....................................................5*

*3.Qëllimi i menaxhimit në vendgjueti........................................................6*

*4.Masat mbrojtëse të kafshëve të egra në vendgjueti...................................6*

*5.Llojet dhe numri i kafshëve të egra në vendgjueti.....................................7*

*5.1 Llojet ë shtazëve dhe shpezëve që momentalisht gjenden në vendgjueti..........7*

*5.2 Tabela skjaruese..............................................................................8*

## *HYRJE*

*Me qëllim të rritjes kultivimit,mbrojtjes,shfrytëzimit të kafshëve të egra dhe menaxhimit më të mirë të tyre,themelohet kjo vendgjueti.Në bazë të analizave të konfiguracionit të terenit,llojet e kafshëve dhe lartësisë mbidetore,konsiderojmë se vendgjuetia në Komunen e Vitisë përfshinë tri zona : Zona menagjuese* ***"Kopilaqa"****,Zona menagjuese* ***"Goshica"*** *dhe Zona menagjuese* ***"Zhegovci"****.*

*Pas konsultave me disa komuna që kanë themeluar vendgjueti të përbashkëta,si dhe duke u bazuar në traditën e gjuetisë në Komunën e Vitisë,vendosem që në Komunën e Vitisë të jetë një vendgjueti ,pasi që sipas përvojave të komunave tjera,që kanë dy apo më shumë vendgjueti,janë përcjellë me vështirësi me përzierje kompetencash dhe mosmarrveshje tjera mes menaxherëve të operatorëve të këtyre vendgjuetive.*

## *EMËRTIMI I VENDGJUETIS*

*Duke pasur parasysh se vendgjuëtia në komunën tonë shtrihet pothujse në tërë regjionin e kopilaqes,prandaj emërtimi* ***"Kopilaqa"****është I natyrshëm dhe propozohet që emërtimi të jetë vendgjuetia* ***"Kopilaqa"***

## *1.SHËNIMET E PËRGJITHSHME PËR VENDGJUETIN*

*Vendgjuetia* ***"Kopilaqa"*** *shtrihet në pjesën jugore të Kosovës,buzë kufirit shtetëror me Republikën e Maqedonis së Veriut,I takon masivit të pyjeve të Karadakut të Shkupit,kryesisht shtrihet në pjesën veriore të këtij masivi.Në pjesën veriore shtrihet deri në shtratin e lumit Morava. Kjo vendgjueti në gjirin e vet ka maja të larta,gryka,shkëmbinjë të thepisur,lugina,rrafshnalta dhe forma të tjera të relievit,si forma karakteristikë të përthyeshmëris së tij.Emërtimi i vendgjuetisë është bërë nga maja më e lartë që quhet* ***"KOPILAQA****"apo Kodra Furrës, me lartësi mbidetore (****479 -1492*** *m),me një sipërfaqe prej* ***6176.75 ha*** *pastaj në pjesën veriore vazhdon me zonën pyjore* ***"Zhegovci"****,që shtrihet në lartesin mbidetare(****479-830*** *m),me sipërfaqe prej* ***1392.47*** *ha,që kufizohet me Komunën e Gjilanit dhe Ferizajit,ndërsa nga pjesa perendimore kufizohet me pyjet e zonës menagjuese* ***"GOSHICA"****,e cila shtrihet në lartësi mbidetare pre* ***560-941****,kjo zonë pyjore në total ka* ***2764.93 ha*** *pyje dhe toka pyjor,e cila kufizohet me Komunën e Kaqanikut .*

## 1.1 KONFIGURACIONI I TERENIT

*Karakteristikë tipike për këtë vendgjueti është konfiguracioni kodrinoro-malor,që karakterizohet me thyerje të theksuara të terenit, me pjerrtësi të theksuara të relievit,ku në sipërfaqe të vogla gjenden forma të ndryshme të relievit e shpeshëherë me thyerje ekstreme.Si normë për densitetin e pyjeve në këtë lloj tereni,ku pika më lartë e lartësisë mbidetare është 1492 m, në vendin e quajtur "**Kopilaqa**" te **kodra e furrës**, kemi pjesë të terenit të pjerrët,që duhet të jenë së paku 20 km/1000 ha.*

*E gjithë hidrografia e kësaj vendgjuetie përbëhet nga ujëmbledhësi i lumit Morava,si pjesë e pellgut të **Detit të Zi**.Kushte të tilla orografike,pedologjike dhe klima e përshtatshme,mundësojnë paraqitjen e grumbujve me numër të madh të llojeve dhe me strukturë shumë heterogjene ,në të cilat pyje rritet numër i konsiderueshëm i florës dhe faunës autoktone.*

*Në këtë vendgjueti egzistojnë rrugë: për kamion,për traktor dhe shtigje të ndryshme*

## 1.2 KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

*Në vendgjuetin "**Kopilaqa**",për shkak të përbërjes litologjike të nduardurshme,klimës karakteristike dhe vegjetacionit,janë zhvilluar edhe lloje të ndryshme të tokave.Klima është e varur nga lartësia mbidetare dhe faktorit vjetor të të reshurave të shiut.Varësisht nga këta faktorë,klima që dominon është e karakterit humid.*

*Vegjetacioni është poashtu faktorë I cili ka ndikuar në krijimin e tokave.Është i kushtëzuar nga substrati,klima ,pozita dhe madhësia e masivit.Me rritjen e lartësisë,krahas ndërrimit të tipit të vegjetacionit,ndrrojnë edhe llojet e tokave.Karakteristikat e tokave në pyjet e brezit kodrinoro-malor,në rend të parë varen prej karakterit të substratit.Në shkëmbnjt gëlqerorë janë krijuar tokat gështenje gëlqerore,ndërsa në shkëmbinjët silikat tokat gështenje acidike.*

*Në shkëmbinjët gëlqerorë janë krijuar tipe të ndryshme të tokave : Sirozemi (tokat gurore),Protoredzina dhe tokat e zeza organogjene në carbonate (redzina e vertetë),me shumë variatete ,terra fusca etj.*

## 1.3 KUSHTET HIDROGRAFIKE

*Hidrografia është element i rëndësishëm natyror për vendgjuetin"**Kopilaqa**",ujrat siperfaqësore dhe nëntokësore varen nga përbërja gjeologjike (ujëmbajtëse dhe ujlëshuese),format relievit,klima (temperaturë,reshjet,erërat etj.),mbulesa vegjetative dhe ndikimi i njeriut në rregullimin e shtretërve dhe shfrytëzimit të ujit për nevoja të ndryshme.Numri I burimeve dhe gurrave gjenden në viset malore të cilat konë rënje të vogël dhe pa shpejtësi dhe forcë erozive,ndërsa në viset e ulta ato marrin formën e ujrave të qeta dhe kanë të gjitha karakteristikat e lumenjëve të rrafshët.Ujëmbledhësi kryesorë në Komunën e Vitisë është "**Morava e Binqës**"i cili e ka burimin në vendin e quajtur "**Bilak**" që është degë e **Karadakut të Shkupit,** me degët e saj,proska e **Gërnqarit dhe e Debëlldehut** si dhe proska tjera ne **Goshice dhe Smirë***

## 1.4 INFRASTRUKTURA E VENDGJUETISË

*Në këtë hapsirë të vendgjuetisë i vetmi vend urbanistikë është **Qyteti i Vitisë** që përmes rrugëve regjionale është i lidhur me **Kllokotin,Gjilanin,Kaqanikun dhe Ferizajin**.Pjesa dërmuese e vendgjuetisë ka infrastrukturë rrugore mjaft të mirë,disa janë edhe të asfaltuara,ka edhe rrugë dytësore kryesisht të rregulluara mirë.Pjesët e vengjuetisë më të largëta mbulohen nga rrugët e fshatrave,që disa prej tyre janë mjaft të vështira të kalohen edhe në stinën e verës,sidomos në fshatrat e braktisura siq janë: fshati **shashare,vërnakolla,vërnezi** si dhe fshati **mjak**.Në pjesën më të madhe të vendgjuetisë vendbanimet janë të pakta.*

## 1.5 QETËSIA NË VENDGJUETI

*Në përgjithësi qetësia në vendgjueti është në nivelin e duhur që ju mundëson jetë të qetë të gjitha egërsirave në teren.*
*Në këto sipërfaqe në qrregullimin e cilësisë,në vendgjueti,ndikon tipi I shprëndarë I vendbanimeve, me lagje të shprëndara,kullotat e pakontrolluara të bagëtisë,qent dhe macat endacake,numri i madh I predatorëve (grabitqarve),gjuetia ilegale ,prerja e pyjeve,qarkullimi I komunikacionit dhe punimet e përditshme në bujqësi.*

## 1.6 NDIKIMI ANTROPOGJEN

*Ndikimi antropogjen ne vendgjuetin "**Kopilaqa**" nuk është edhe aq I madh posi qe pjesa dermuese e siperfaqes mbulohet me pyje,livadhe dhe kullosa,ndersa toka te punuara ka me pak dhe gjenden afer rrugeve të vendbanimeve.Prerja e pakontrolluar e pyjeve paraqet nje problem në vete,sidomos prerjet ilegale ndikojnë negativisht në kultivimin dhe qetësin e egërsirave por edhe në ushqimin e tyre,duke I përmendur edhe zjarret e qfaqura nga faktori njeri.Sa i perket përdorimit të mekanizmave bujqësore dhe përdorimit të preparateve kimike,ndikimi i tyre nuk është shumë i madh.Kushtet ekologjike ato janë në përmirësim në krahasim me të kaluaren,por ka mundësi që kushtet ekologjike të përmirësohen edhe më tej.Për shkak të gjuetis ilegale dhe gjuetisë me mjete të ndaluara,numri i egërsirave është duke u zvogeluar qdo herë e më shumë,prandaj kjo dukuri duhet të luftohet me të gjitha mekanizmat e shoqatës,si dhe me ndihmen e organeve shtetërore.*

## 1.7 KUSHTET KLIMATIKE

*Sa I përket klimës në kuptimin makro klimatik dhe rajonal është varijanti klimës së mesme kontinentale e cila në lartësin e madhe mbidetare është me vlera të theksuara të temperaturave ekstreme e ndikuar nga përthyerja e madhe e terenit dhe paraqitje të elementeve të ndryshme të klimës kontinentale.Temperaturat mesatare në muajin korrik janë **21°C,** ndërsa në muajin janar **-0.5° C**. Sasia e të reshurave është **385-950 mm/vit** (mestarisht **590 mm/vit**).Gërshetimi i klimës kontinentale dhe format kalimtore të tyre janë forma standarde të shtrirjes në këtë njësi menaxhuese.*

*Ky gërshetim i klimës ka krijuar një kompleks të ndërlikuar të kushteve ekologjike të cilat mundësojnë paraqitjen dhe egzistencën e florës dhe faunës të begatshme dhe të shumëllojshme.*

*Vendgjuetia gjithashtu shquhet edhe për shumëllojshmëri biologjike të pejsazheve,falë pozicioneve gjeografike,kushteve gjeologjike,pedologjike, hidrologjike të karakteristikave të relievit dhe klimës.Relievi I thyer dhe kushtet tjera për egzistencë dhe ruajtjen e një numri të madh të llojllojshëm të botës bimore dhe shtazore.*

## 1.8 VEGJETACIONI NË VENDGJUETI

*Të gjitha terenet e kësaj vend gjuetie karakterizohen me vegjetacion të bujshëm të florës,duke iu falenderuar kushteve pedologjike dhe numrit të madh të lumenjve,përroskave dhe burimeve natyrale të ujit.Egërsirat kanë sasi të mjaftueshme dhe të shumëllojshme të ushqimit gjatë tërë vitit ,veqanarisht në periudhën verore me temperaturë të larta.*

*Egzistojnë shumë kullosa malore,livadhe ku egërsirat ushqehen dhe krijojnë venbanimet e tyre.Në pjesët e rrafshta dhe në ultësira mbillen arat me drithëra si : **gruri,misri,**etj.Ku egërsirat e imta mundë të gjejnë ushqimin plotësues.Në zonat malore prezent janë tipet e drunjëve : ahu,bungu,qarri,shkoza,plepi i egër, molla e egër,dardha e egër,thana,lajthija,shelgu,etj,ndërsa nga drunjët e shkurtër dallohen:kaqa,murrizi,kulumria,manaferra,etj që gjithashtu paraqesin ushqim kualitativ për egërsira.*

## 1.9 USHQIMI PLOTËSUES I EGËRSIRAVE

*Në pjesët më të larta të terenit të vendgjuetisë dimrat janë më të ashpër dhe më të gjatë,me sasi më të madhe të borës dhe ngricave,prandaj mundësisht duhet ti kushtohet vëmendje edhe ushqimit plotësues të egërsirave.Ndër egërsirat më të rrezikuara gjatë dimrit janë gjithesesi,thëllënzat fushore dhe derri I egër të cilat nga temperaturat e ulta mundë të pësojnë.Nga egërsirat tjera dreri dhe lepuri janë gjithashtu të rrezikuara,prandaj do të ishte I nevojshëm ushqimi shtesë I përbërë nga sana,tërfoja,drithi apo kultura tjera.Prandaj varsisht nga kushtet materjale preferohet të sigurohet ushqimi i përbërë nga drithi dhe bari i tharë ( sana apo tërfoja).Në disa vende në vengjueti duhet ngritur ushqimore ( kryesisht duke I shfrytëzuar drunjët e pyllit) ,në të cilat vendoset ushqimi plotësues për egërsira të larta.Poashtu në disa vende duhet ndërtuar kripore të përshtatshme,ku vendoset kripa,kryesisht në formë gurore të cilat egërsirat mundë ti shfrytëzojnë,por pa pasur mundësi ta zhvendosin ose ti hedhin në tokë*

## 2. SHËNIMET THEMELORE PËR VENDGJUETIN,KUFIJT E VENDGJUETIS

*Në aspektin e shtrirjes katastrale vendgjuetia kryesisht shtrihet brenda kufijve komunal të Komunës së Vitis,në sipërfaqe prej* **26993.59 ha.** *Nga pjesa jugore,kjo vendgjueti kufizohet me* ***Repuliken e Maqedonisë se veriut****,nga pjesa veri-lindore me* ***Komunen e Gjilanit****,nga pjesa perendimore me* ***Komunen e Ferizajit****,si dhe nga pjesa jug-perendimore me* ***Komunen e Kaqanikut.*** *Këto pyje janë vazhdim I* ***Maleve Rodope*** *dhe të njejtat bëjnë pjesë në kategorin e maleve të vjetra të cilat kryesisht përbëhen prej shkëmbinjëve gëlqeror.Bota e gjallë e vendgjuetis është e përfaqësuar me një numër të madhë të florës autoktone dhe faunes së egër.Vegjetacioni është i begatshëm dhe i llojllojshëm,para së gjithash se edhe bota jo e gjallë është e begatshme.Begatia e botës së gjallë është rezultat I proceseve historike dhe evolutive si pasojë e pozitës së volitshme gjeografike.Kryesisht përbëhet nga dy breze Pyjore dhe atë : nga pyjet e ulta të brezit kodrinoro-malor me pjesmarrje të llojeve karakteristike për këtë brez ,****Querqus Frainetto(bung)****,* ***Querqus cerris(qarri),Querqus petrea(dushku I koprollit)****,Fagus* ***mesiaca(ahu),Carpinus orientalis(shkoze orientale),Carpinus detulus(shkoze)*** *dhe llojet e tjera të drunjve dhe shkurreve që janë karakteristike për këtë brez pyjor ,si dhe brezin malor të pyjeve të larta të ahut dhe llojeve tjera përcjellëse që janë karakteristike për këtë brez.*

## 2.1 STRUKTURA E SIPERFAQES SË VEND GJUETISË

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Sip. e përgjithshme e vendgjuetisë | 26993.59 | ha | 100 | % | Vërejtje |
| Pyje dhe toka pyjore | 10334.15 | ha | | % | E lejuar për gjueti |
| Kullosa dhe livadhe | 1985.00 | ha | | % | E lejuar për gjueti |
| Pemishte | 224.00 | ha | | % | E ndaluar per gjueti |
| Tokë e punueshme bujqësore | 10703.55 | ha | | % | E lejuar |
| Pem te imta | 83.4 | ha | | % | E ndaluar per gjueti |
| Luimenj,kanale | 98.00 | ha | | % | E lejuar për gjueti |
| tjera | 3565.49 | ha | | % | E ndaluar për gjueti |
| Sip.e lejuar për gjueti | 23120.70 | ha | 85.66 | % | E lejuar për gjueti |
| Sip. e ndaluar për gjueti | 3872.89 | ha | 14.34 | % | E ndaluar për gjueti |

## *3. QELLIMI I MENAXHIMIT NE VENDGJUETI*

*Qëllimet e përgjithshme: Menaxhimi i vendguetisë ka për qëllim ruajtjen e tërë ekosistemit dhe barazpeshën ekologjike,mbrojtjen e kafshëve të egra,sigurimin e mirqenjes dhe kushteve të shfrytëzimit të tyre.Gjithashtu siguron mirqenjen dhe kushtet e shfrytezimit ekonomik dhe etiken e gjahtarve.Pra me menaxhim te vengjuetise mundesohet kultivimi,mbojtja,menaxhimi,gjuetia dhe shfrytëzimi I egërsirave dhe pjesëve të tyre ,ashtu që me masat menaxhuese sigurohet kultivimi I atyre egërsirave në lloje,numër dhe kualitete ,që lejojnë kushtet natyrore në vendgjueti.*

***Qëllimet e veqanta :*** *Arritja e numrit dhe kualitetit të caktuar,strukturës gjinore dhe moshore,dendsisë dhe popullimit,mënyra e shfrytëzimit të egërsirave dhe pjesëve të tyre (gjuetia turistike,aktivitetet sportive-rekreative),përmirësimi i kushteve natyrore dhe habitateve të egërsirave.*

## *4. MASAT MBROJTËSE TË KAFSHËVE TË EGRA NË VENDGJUETI*

*Gjuetia ilegale dhe numri shumë i madh i egërsirave dëmëbërese (ujku dhe dhelpra) ,kane bërë që numri i kafshëve të egra në vendgjueti të zvoglohet.Numri i qenve dhe maceve endacake është në rritje e siper,gjë që na shkakton dëme të mëdha sidomos në egërsirat,siq është lepuri,thëllënza por edhe të vegjlit e kaprollit.*

*Mbrojtja e kafshëve te egra nga gjuetia ilegale bëhet në mënyra të ruajtjes së organizuar,nëpër seksione të gjuetisë,ku qdo anëtar i gjuetisë është i paisur me autorizim (bexhë) për kontrollimin e terenit të gjuetisë.*

*Pos kësaj shoqata ka edhe rojtarin e terrenit të gjuetisë i cili është në mardhanje të përkohshme pune.*

*Mbrojtja e kafshëve të egra nga predatorët present dhe të kohëpaskohshëm,numri i të cilëve është mjaft i madh,bëhet kryesishtë duke reduktuar numrin e tyre gjatë sezonit të lejuar për gjueti,e nëse është e nevojshme duhet të organizohet aksion për reduktimin e këtij numri të predatorve, në bashkëpunim me* **MBPZHR dhe DBPZHR**.

*Sa I përket mbrojtjes nga sëmundjet e ndryshme të kafshëve të egra duhet cekur se në terrenin e gjuetisë,nuk është hasur në ndonjë rast të sëmundjeve të egërsirave apo edhe të egërsirave të ngordhura nga sëmundjet.*

*Nëse gjatë kontrollimit të terrenit hasim në egërsira të ngordhura,shoqata si mengjuese e këtyre kafshëve të egra duhet të kontaktoj menjeherë me shërbimin veterinar komunal apo edhe me instancat me të larta në mënyre që të kërkohet ndihmë për mbrojtje nga sëmundjet eventuale të egërsirave.*

## *5. LLOJET E SHTAZËVE DHE SHPEZËVE TË EGRA QË MOMENTALISHT GJENDEN NË VENDGJUETI*

*Vendgjuetia "kopilaqa" në bazë të pozicionit gjeografik kushteve gjeologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të relievit dhe të klimës ,ofron kushte solide për egzistencen dhe ruajtjen e botës shtazore.Me që egzistonë një numër i konsiderueshëm i shtazëve dhe shpezëve të egra siq janë : ariu i murrëm,ujku,dhelpra,ketri,derri i egër,vjedulla,macja e egër,lepuri dhe shpezët e egra siq janë:thëllënza e fushës,thëllnza e gurëve,pula e egër,shqiponja e maleve,fajkoi thonjëbardhë,petriti i pulave ,dallëndyshja e natës,pata-rosa,huti,pëllumbi.*

## *5.1.LLOJET DHE NUMRI I KAFSHËVE TË EGRA NË VENDGJUETI*

*Vendgjuetia* ***"kopiloqa"*** *posedon një numër të konsiderueshëm të kafshëve dhe shpezëve të egra.*

*Derri i egër ka një prezencë më të theksuar në krahasim me kafshët e tjera dhe numri i populacionit të tij është rreth 50 cop.,pastaj vjen ujku me një populacion afërsisht 20 cop,macja e egër 2 cop,vjedulla 15 cop,dreri 5 cop,dhelpra 30 cop,ketri 40 cop,lepuri 50 cop si dhe është vërejtë prezenca e ariut.*

*Prej shpezëve të egra :thëllënza e fushës 200 cop,thëllënza gurore 50 cop,petriti i pulave 20,shqiponja e maleve 3,fajkoi thonjëbardhë 10,pata-rosa 30 cop,huti 15 cop,pëllumbi 200 cop.*

## 5.2 TABELA

| Nr. | Lloji I kafshëve të egra | Numri I kafshëve |
|---|---|---|
| 1. | Ariu | 1 |
| 2. | Derri I egër | 50 |
| 3. | Ujku | 20 |
| 4. | Macja egër | 2 |
| 5. | Vjedulla | 15 |
| 6. | Dhelpra | 30 |
| 7. | Dreri | 5 |
| 8. | Ketri | 40 |
| 9. | Lepuri | 50 |

| Nr. | Lloji i shpezëve të egra | Numri i shpezëve |
|---|---|---|
| 1. | Thëllënza e fushës | 200 |
| 2. | Thëllënza gurore | 50 |
| 3. | Dallëndyshja e natës | 50 |
| 4. | Petriti I pulave | 20 |
| 4. | Shqiponja e maleve | 3 |
| 5. | Fajkoi thonjëbardhë | 10 |
| 6. | Pata-rosa | 30 |
| 7. | Huti | 15 |
| 8. | Pëllumbi | 200 |

| Nr, | Kafshët e egra te cilat jane nen mbrojtje te posaqem | Numri |
|---|---|---|
| 1. | Ariu | 1 |
| 2. | Ketrri | 40 |
| 3. | Maca eger | 2 |
| 4. | Vjedulla | 15 |
| 5. | Shqiponja e malev | 3 |
| 6. | Petriti pulave | 20 |
| 7. | Dreri | 5 |


Kllokot
Pozheres
Mogila
Remnika
Verbovci
Gernova
Terstenika

Leggenda

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
23-11-2020
02-035/02-1234

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, dhe neni 11 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 23, paragrafi 1 dhe 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, bazuar në kërkesën e MAPL-se me Nr. 020-824/5, të datës 16.11.2020, neni 50 paragrai 1 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, kryetari I Komunës së Vitisë propozon këtë;

# PROPOZIM VENDIM

## Për ndryshim plotësim të vendimit Nr. 01-111/01-1055, i datës 29.10.2020 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NPSH „ARENA SPORT“ në Kabash

**Neni 1**

Me këtë propozim – vendim, propozohet të bëhet ndryshim plotësimi i vendimit nr.01-111/01-1055, i datës 29.10.2020 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitisë, NPSh „Arena Sport“ në Kabash, e regjistruar me numër biznesit 70396085.

**Neni 2**

Ndryshim plotësimi ka të bëj tek preambula e vendimit Nr. 01-111/01-1055, i datës 29.10.2020, ku duhet të bazohemi në nenin 11 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 23 paragrafi 1 dhe 2.2 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

**Neni 3**

Pjesët tjera të vendimit Nr. 01-111/01-1055, të datës 29.10.2020 mbesin të pandryshuar.

**Neni 4**

Ky propozim vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë**
**Sokol Haliti**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

23-11-2020
02-035/02-1232

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 58, pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03L-040 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), kërkesën e MAPL-se Nr.020-824/4, të datës 16.11.2020, lidhur me nenin 50 shkronja I të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari I Komunës së Vitisë propozon këtë;

# PROP OZIM VENDIM

## Për shfuqizimin e Vendimit Nr.02-110/05-1052, të datës 29.10.2020, nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal të kryetarit të Komunës së Vitisë me komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, etj

**Neni 1**

Kryetari i Komunës së Vitisë, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë shfuqizimin e Vendimit Nr.02-110/05-1052 të datës 29.10.2020, nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal të kryetarit të Komunës së Vitisë me komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, etj.

**Neni 2**

Shfuqizimi propozohet me kërkesën e Ministrisë së Pushtetit Lokal pasi që është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

**Neni 3**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

**Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë**
**Sokol Haliti**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

23-11-2020
02-035/02-1233

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 58, pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03L-040 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), kërkesën e MAPL-se nr.020-824/3, të datës 16.11.2020, lidhur me nenin 50, shkronja l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari I Komunës së Vitisë propozon këtë;

# PROP OZIM VENDIM

**Për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-1053, të datës 29.10.2020 për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunim ndërkomunal me komunat e Republikës së Kosovës**

**Neni 1**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-1053, të datës 29.10.2020, për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunim ndërkomunal me komunat e Republikës së Kosovës.

**Neni 2**

Shfuqizimi propozohet me kërkesën e Ministrisë së Pushtetit Lokal, pasi që është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

**Neni 3**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

**Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë**
**Sokol Haliti**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
24-11-2020
02-035/02-1247

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 nën paragrafi 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 nën paragrafit 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja L të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

**NISMË**
**PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË ME KOMUNEN E GJILANIT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

1. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunen e Gjilani.

2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

3. **Bashkangjitur** me nismë do të paraqesim mendimin me shkrim dhe të arsyetuar dhe vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendit i Komunës së Vitisë, me të cilin vendim për miratim të nismës do të njoftohet kryetari i komunës së Gjilanit me të cilët tentojmë të kemi bashkëpunim.

4. **Arsyetim**- Komuna e Vitisë dhe komuna e Gjilanit kanë shprehur paraprakisht vullnetin e tyre për bashkëpunim dhe janë pajtuar që përmes zyrave të projekteve përkatëse të komunave të bashkëpunojnë në sferën e infrastrukturës së përgjithshme në projekte me interes të përbashkët në infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj, që do të lidh komunat mes veti. Ndërtimi i bashkëpunimit do të lidhë fshatrat e kësaj treve dhe lehtëson që popullata lokale e kësaj treve të komunikojnë me lehtë me qendrat komunale.

Propozues:

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
Pranuar - Primljeno 24-11-2020
Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
02-035/02-1249

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

## PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN

## E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL ME KOMUNEN E GJILANIT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.

**Neni I**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton nismën për bashkëpunimin nder-komunal me Komunen e Gjilani në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**Neni II**

Bashkëpunimi nder-komunal do të zhvillohet me komunen e Gjilanit.

**Neni III**

Detajet e bashkëpunimit do te përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

**Neni IV**

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vetisë.

**Neni V**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar-Primljeno më/dana: 24-11-2020
Nr.i organit / Org.broj: 02-036/02-1248

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

**PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNEN E GJILANIT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

**Neni I**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton propozim vendimin për AUTORIZIMIN e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunen e Gjilanit për bashkëpunimin nder-komunal në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**Neni II**

Pas marrjes së autorizimin Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës përkatëse për nismën me të cilin kërkohet themelimin i bashkëpunimit nder-komunal.

**Neni III**

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vetisë.

**Neni IV**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
24.11.2020
02-035/02-1244

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 nën paragrafi 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 nën paragrafit 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja L të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

**NISMË**
**PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË ME KOMUNEN E FERIZAJIT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

**1.** Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunën e Ferizajit.

**2. Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**3. Bashkangjitur** me nismë do të paraqesim mendimin me shkrim dhe të arsyetuar dhe vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendit i Komunës së Vitisë, me të cilin vendim për miratim të nismës do të njoftohet kryetari i komunës së Ferizajit me të cilët tentojmë të kemi bashkëpunim.

**4. Arsyetim-** Komuna e Vitisë dhe komuna e Ferizajit kanë shprehur paraprakisht vullnetin e tyre për bashkëpunim dhe janë pajtuar që përmes zyrave të projekteve përkatëse të komunave të bashkëpunojnë në sferën e infrastrukturës së përgjithshme në projekte me interes të përbashkët në infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj, që do të lidh komunat mes veti. Ndërtimi i bashkëpunimit do të lidhë fshatrat e kësaj treve dhe lehtëson që popullata lokale e kësaj treve të komunikojnë me lehtë me qendrat komunale.

P r o p o z u e s:

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno: 24-11-2013
Nr.i organit / Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë / Prilog | Vlera / Vrednost
02-035/02-1241

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

## PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN

## E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL ME KOMUNEN E FERIZAJIT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.

**Neni I**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton nismën për bashkëpunimin nder-komunal me Komunën e Ferizajit në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**Neni II**

Bashkëpunimi nder-komunal do të zhvillohet me komunën e Ferizajit.

**Neni III**

Detajet e bashkëpunimit do te përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

**Neni IV**

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vetisë.

**Neni V**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno: 24-11-2020
02-035/02-1246

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

## PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNEN E FERIZAJIT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.

**Neni I**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton propozim vendimin për AUTORIZIMIN e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Ferizajit për bashkëpunimin nder-komunal në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**Neni II**

Pas marrjes së autorizimin Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës përkatëse për nismën me të cilin kërkohet themelimin i bashkëpunimit nder-komunal.

**Neni III**

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vetisë.

**Neni IV**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Datum - Pranjena Mëdata 24-11-2020 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.I organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojca Prilog | Vlera Vrednost |
| 02-035/02 -1241 | | | |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 nën paragrafi 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 nën paragrafit 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja L të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

**NISMË**
**PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË ME KOMUNEN E KAQANIKUR NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

1. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunën e Kaqanikut.

2. **Qëllimi i bashkëpunimit-** bashkëpunimi do të bëhet në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

3. **Bashkangjitur** me nismë do të paraqesim mendimin me shkrim dhe të arsyetuar dhe vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendit i Komunës së Vitisë, me të cilin vendim për miratim të nismës do të njoftohet kryetari i komunës së Kaqanikut me të cilët tentojmë të kemi bashkëpunim.

4. **Arsyetim-** Komuna e Vitisë dhe komuna e Kaqanikut kanë shprehur paraprakisht vullnetin e tyre për bashkëpunim dhe janë pajtuar që përmes zyrave të projekteve përkatëse të komunave të bashkëpunojnë në sferën e infrastrukturës së përgjithshme në projekte me interes të përbashkët në infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi etj, që do të lidh komunat mes veti. Ndërtimi i bashkëpunimit do të lidhë fshatrat e këSaj treve dhe lehtëson që popullata lokale e kësaj treve të komunikojnë me lehtë me qendrat komunale.

Propozues:

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
24-11-2020
02-035/02-1243

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

**PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN**

**E KRYETARIT TË KOMUNES SË VITISË PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL ME KOMUNEN E KAQANIKUT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

**Neni I**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton nismën për bashkëpunimin nder-komunal me Komunën e Kaqanikut në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**Neni II**

Bashkëpunimi nder-komunal do të zhvillohet me komunën e Kaqanikut.

**Neni III**

Detajet e bashkëpunimit do te përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

**Neni IV**

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vetisë.

**Neni V**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Međuna 24-11-2022
Nr.i organit Org.broj 02 | Numri/Broj 035/02-1242 | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 6 pika 2.1 të Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim nder-komunal dhe nenit 5 pila 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder-komunal, nenit 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë

**PROPOZIM VENDIM PËR NISMËN**
**E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNEN E KAQANIKUT NË FUSHAT E PËRGJITHSHME SI INFRASTRUKTUR RRUGORE, EKONOMI, BUJQESI, ETJ.**

**Neni I**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal të Vitisë të miraton propozim vendimin për AUTORIZIMIN e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kaqanikut për bashkëpunimin nder-komunal në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.

**Neni II**

Pas marrjes së autorizimin Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës përkatëse për nismën me të cilin kërkohet themelimin i bashkëpunimit nder-komunal.

**Neni III**

Ky propozim vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të mandatit të Kryetarit të Komunës së Vetisë.

**Neni IV**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti